



Kolegji ESLG

PLANI VJETOR ZHVILLIMOR I KOLEGJIT ESLG

Në pajtim me premisat themelore të themelimit të saj, ESLG-ja ka parashtruar qëllimet si në vijim në kuadër të planit zhvillimor afatshkurtër një vjeçar dhe atij afatmesëm:

1. Rritja e bashkëpunimit me Kolegjin UBT dhe kolegjet simotra pjesë e UBT-së;
2. rritja e numrit të studentëve të studimeve elementare në nivel kombëtar të Kosovës dhe ofrimin e mundësisë së studimit me orar të plotë për një numër të madh të kandidatëve të mundshëm;
3. rritja e numrit të studentëve të studimeve posdiplomike në programet master dhe të doktoratës;
4. ofrimi i programeve të reja interdisciplinare posdiplomike;
5. sigurimi i mobilitetit të plotë të studentëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me një strukturë të qartë të sistemit të kredive bazuar në sistemin evropian të kredive (ECTS) duke dërguar studentët për vizitë studimore në EVRO-PF dhe Fakultetin e Studimeve Qeveritare dhe Evropiane;
6. vendosja e studimit dhe punës hulumtuese të pavarur të shoqëruar me mentorim e cila kryesisht do të sigurojë vlerësimin e punës së tillë në sistemin e kredive;
7. botimi i konkluzioneve hulumtuese në publikimet shkencore vendëse dhe të huaja;
8. përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me institucionet tjera akademike në fushën e mësimdhënies (p.sh shkëmbimi i profesorëve dhe hulumtuesve, shkollave të përbashkëta verore) të cilat do të kontribuojnë në njohjen ndërkombëtare të ESLG-së;
9. fuqizimi i aktivitetit të librarisë duke rritur numrin e njësive të librarive dhe zgjerimi i integritit në nivel të librarive vendëse dhe ndërkombëtare;
10. Botimi i publikimeve vetanake dhe të revistave dhe përfshirjen e tyre në listat e publikimeve referuese;

Objektivat afatshkurta të ESLG-së janë si në vijim:

1. Tranzicionimi sa më i shpejtë dhe më i lehtë i të qenurit pjesë përbërëse e grupit të UBT-së;
2. 100% realizueshmëri të aktivitetit të planifikuar studimor (ligjëratat dhe ushtrimet) në të gjitha programet e studimeve elementare dhe të atyre posdiplomike;
3. 90% e studentëve plotësojnë kushtet për kalimin në vitin e ardhshëm në të gjitha programet akademike;
4. 150 të diplomuar në programet e studimeve bachelor dhe 50 në programet master;
5. implementimi i suksesshëm i studimeve të doktoratës dhe 90% e kandidatëve për

Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës

T: +383 38 602 405

T: +383 44 159 867

E: info@eukos.org

W: www.eukos.org



Kolegji ESLG

- doktoraturë plotësojnë kushtet për kalimin në vitin e ardhshëm;
6. fillimi i punës hulumtuese nga grupet hulumtuese;
 7. themelimi i programeve të reja të akredituara në nivel bachelor dhe të studimeve posdiplomike;
 8. pajisja me staf të ri;
 9. themelimi i kontakteve të reja me institucionet akademike të rangut të lartë në BE dhe ftesa për profesorët e huaj vizitues;
 10. organizimi i konferencave ndërkombëtare dhe shkollës verore;
 11. pajisja e librarisë me literaturën e planifikuar në studimet elementare dhe posdiplomike;
 12. fillimi i një reviste ndërkombëtare referuese;
 13. zhvillimi i anketave me studentë;
 14. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të shtohet implementimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndëruniversitar
 15. Intensifikimi i partneritetit me Universitetin e Prishtinës dhe universitetet tjera në regjion.
 16. Absorbimi i fondeve të Komisionit Evropian.
 17. Themelimi i projekteve të mësimi tërëjetësor në ESLG (LLL-Socrates-Erasmus, Erasmus Mundus, Leonardo da Vinci)
 18. Themelimi i Institutit për të Drejtën Krahasimore, Instituti për Menaxhimin e Patundshmërive dhe Qendrës për Studime Evropiane.
 19. Projekti i Universitetit veror me studentë nga Sllovenia.

PLANI VJETOR I REKRUTIMIT TË STUDENTËVE

Për shkak të numrit të madh të grupeve shënjestra, qasja në vijim do të shfrytëzohet:

- Panairë të rekrutimit të studentëve nëpër tërë shkollat e mesme të Kosovës. Para diplomimit nëpër shkollat të mesme ekipi i rekrutuesve të trajnuar enkas për këtë punë do të organizojnë panairë të rekrutimit nëpër shkollat të mesme dhe do të përpiqen të tërheqin studentët më të shkëlqyeshëm të shkollave të mesme duke i'u ofruar atyre edhe mundësi për shkëmbim të studentëve një vjeçar në Slloveni.
- Prezentimet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Administratës Publike para nëpunësve civil të cilët dëshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e të drejtës evropiane dhe në studimet e BE-së dhe diplomacisë.



Kolegji ESLG

- Prezentimet nëpër komunat e Kosovës dhe Zyret Kadastrale për ata që dëshirojnë të kryejnë studimet në menaxhimin e patundshmërive me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave pronësore në Kosovë.
- Prezentimet para stafit lokal të organizatave ndërkombëtare sikur EULEX, ICO, OSBE, dhe misionet diplomatike me qëllim të identifikimit të stafit lokal me përvojë i cili dëshiron të zgjerojë horizontet e diturisë në çështjet e BE-së.
- Organizimi i ligjëratave me figura të njohura politike të Sllovenisë mbi procesin e aksesionit siç është Dr.Dimitrij Rupel.
- Faqja interactive dhe dinamike e internetit dhe kutia e kontaktit për studentët potencial bazuar në të cilën broshurat dhe pakot informuese do t'ju dërgohen atyre. Një chat i gjallë në internet do të jetë në dispozicion për studentët e mundshëm dhe të gjitha paqartësitë e tyre.
- Organizimi i Ditës së Vizitës për studentët e mundshëm të cilët dëshirojnë të takohen me profesorët e mundshëm slloven personalisht dhe me stafin akademik kosovar.

PLANI VJETOR I ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE NË ESLG

Zhvillimi i shërbimeve përfshin krijimin e shërbimeve të karrierës së siguruar për studentët tanë dhe alumni. Qëllimi i ofrimit të shërbimeve të karrierës për studentëve tanë është që t'i bëjë ata më konkurrues në tregun e punës. Duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë, konkurrenca gjithashtu është e fortë, e cila vendos një presion të madh mbi të sapodiplomuarit. Kështuqë, ne do t'u ofrojmë atyre shërbimin e karrierës, i cili në veti ngërthen edhe angazhimin tonë për gjetjen e punës për studentët tanë brenda rrjetit tonë të kontakteve, dhe miqtve të institucionit tonë.

Trajnimet certifikuese janë një tjetër objektivi me të cilat ne do të përpiqemi të bëhemi udhëheqës në tregun e Kosovës. Trajnimet certifikuese do të mbahen në kuadër të Qendrës për studime të BE-së në ESLG. Trajnimet e planifikuara janë Menaxhimi i Projekteve, Aftësitë e Udhëheqjes, Menaxhimi në Kontekst Global, Menaxhimi i Fondeve të BE-së, Qasja në fondet e IPA-së të BE-së, e kështu me radhë varësisht se cilat janë nevojat e tregut tonë.

Zhvillimi i Institutit për Menaxhim të Patundshmërive do të ofrojë kurse trajnuese në menaxhimin e patundshmërive. Instituti gjithashtu do të kërkojë të marrë leje nga autoritetet kompetente qeveritare në mënyrë që të sigurojë që ky Institut të jetë i licencuar për vlerësimin e pasurive.



Kolegji ESLG

Qendra e Hulumtimit në kuadër të ESLG-së do të ofrojë arsimim të rangut të lartë në Kosovë dhe rajon. Hulumtuesit do të jenë nga rradhët e profesionistëve të njohur nga praktika në fushat e tyre të hulumtimit të cilët do të publikojnë rezultatet e tyre të hulumtimit shumë shpesh. Qendra gjithashtu do të jetë në gjendje të ofrojë hulumtim dhe të përpilojë raporte të ndryshme të bazuar në hulumtim dhe forma të tjera të publikimeve të dedikuara për qeverinë dhe palët tjera të interesuara në Kosovë dhe rajon.

Për më tepër, qendra e hulumtimit gjithashtu do të themelojë dhe publikojë një Revistë të quajtur Rishikimi i Drejtësisë, fillimisht në baza vjetore dhe mëpastaj revista në fjalë do të botohet edhe në baza tremujore.

Këto dy funksione të Qendrës së Hulumtimit do të plotësojnë njëra tjetrën në atë mënyrë ashtuqë një qasje krejt tjetër ndaj hulumtimit dhe publikimit do të përdoret në Kosovë.

Prof. Dr. Edmond Hajrizi
Kryetar i Bordit

Prishtinë (Kosovë), 20 gusht 2019



Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës

T: +383 38 602 405

T: +383 44 159 867

E: info@eukos.org

W: www.eukos.org